

FATOS KONGOLI

VEPRA

LËKURA E QENIT

ROMAN

6

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

VEPRA

1. Ne të tre - *roman*
2. I humburi - *roman*
3. Kufoma - *roman*
4. Dragoi i fildishtë - *roman*
5. Ëndrra e Damokleut - *roman*
6. Lëkura e qenit - *roman*
7. Te porta e Shën Pjetrit - *roman*
8. Jetë në një kuti shkrepësesh - *roman*
9. Në pritje të Nostradamusit - *tregime*
10. Karuseli - *roman*
11. Bolero në vilën e pleqve - *roman*
12. Iluzione në sirtar - *autobiografi*
13. Si-do-re-la - *roman*
14. Njeriu me fat - *roman*
15. Gjemia e mbytur - *roman*
16. Gënjeshtarë të vegjël - *roman*
17. Kapitulli i Amerikës - *autobiografi*
18. Stinë pandemie - *roman*
19. Misteri i mjellmës - *roman*
20. Ballo me maska ose shakaja e fundit - *roman*

FATOS KONGOLI
VEPRA

LËKURA E QENIT

roman

6

BOTIMET TOENA

Botim i veçantë në kuadër të Veprës.

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Gea Qendro

ISBN 9789928960436

© AUTORI dhe BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Lilit,
bashkëshortes sime

1.

Praninë e Hadit-Hadesi i grekëve të lashtë ose Plutoni i romakëve - e vura re kur u sëmur Marga, gruaja ime. Më saktë ish-gruaja ime sepse ajo ka vdekur, po mbush një vit që ka vdekur. Ai, sigurisht, nuk ishte perëndia mitologjike e grekëve apo romakëve të lashtë. Ishte një person i rëndomtë nga raca jonë e krijesave kalimtare në këtë botë dhe mua nuk më kujtohet mirë se kur e në ç'rrethana e quajta me këtë emër. Mbase më ndodhi ta quaja kështu për shkak të asaj që përcaktohet si shoqërim idesh. Gjithçka që një shoqërim idesh, asgjë më shumë.

Ndërkaq dëgjoj të thuhet se edhe Hadi ka vdekur. Unë nuk e shoh më në vendin e tij të përhershëm, nuk ndiej më vështrimin e tij, as të qeshurën e zezë. Por nuk i besoj ato që thonë. Thashethemi sipas të cilit ai paskej vdekur gjatë mungesës sime duhet të jetë një dredhi për të më prishur mendjen, për të më futur në kurth. Kjo pak a shumë do të thotë që në murin e lajmërimeve të rrugica që të çon prapa pallatit ku banoj, të ngjitet fleta me njoftimin e vdekjes sime.

E shoh, po ngatërrohem. Dua të rrëfej një histori dhe pa dashur po e bëj lëmsh. Më keq akoma, po e nxij. Dhe, dihet, gjërat e ngatërruara, për më tepër të nxira, nuk i do njeri. Do të ishte e arsyeshme, pra, ta nisja me diçka më të qartë, pa ndërlikime, fjala vjen me diçka për veten. Kështu ndoshta ndjekja e kësaj historie, që u hap në mënyrë jo fort premtuese me vdekjen e Margës dhe të quajturin Had, do të ishte më e lehtë. Mundësisht komike. Aq sa njerëzit të shqydheshin gazit, të shqyhem dhe unë bashkë me ta.

Më quajnë Krist Tarapi. Emri im u kujtonte njerëzve Krishtin dhe, siç dihet, dikur, jo shumë larg, te ne Krishti ka qenë një personazh i shpallur armik. Shënoj se megjithë shpalljen armik të Krishtit, emri nuk më ka hapur telashe. Ishte vetëm një emër dhe unë, në sjelljet dhe veprimet e mia nuk kam pasur asgjë prej Krishti, pra nuk mendoj se paraqisja ndonjë rrezik. Përkundrazi, sado e çuditshme të duket, problematik për mua ka qenë mbiemri. Jam përpjekur shpesh t'i gjej një domethënie, por askush nuk ishte në gjendje të ma shpjegonte. Domethënien në një farë mënyre e gjenin dashakeqët e mi. Ata kishin një prirje për ta thjeshtuar mbiemrin tim dhe nga Tarapi e kthenin në Trapi. Edhe sot e kësaj dite ka njerëz që plot mirësjellje më thërrasin “zoti Trapi!”

Nuk e di nëse ky shtrembërim tekefundit përmbante një të vërtetë, pra një shkallë trapllëku timin, nëse më lejohet të shprehem

kështu. Por, meqë unë dua të tregoj një histori, parapraakisht po kërkoj falje. Këtë nuk e bëj nga ndonjë lloj kompleksi, që e ka burimin te shtrembërimi i mundshëm i mbiemrit tim. Arsyeja është më praktike: kur kërkon t'u thuash të tjerëve diçka, me një fjalë t'u harxhosh gjënë më të çmuar, kohën, ka të ngjarë që me naivitetin tënd, mbase me budallallëkun, t'i mërzitësh. T'i lëndosh e, më tej, të dalësh edhe vetë në dritë të keqe. Mua nuk më tremb gjasa se mund të dal në dritë të keqe. Sipas dëshirës, e mira dhe e keqja marrin kuptime relative. Ndërsa sipas një filozofie të lashtë që njerëzit e kanë shpikur për t'u vetëngushëlluar në rrethana të caktuara, e mira nuk është gjithnjë e mirë, e keqja nuk është gjithnjë e keqe. Ka të mira që vijnë për keq, ka të këqija që vijnë për mirë. Siç është rasti i aventurës sime të fundit. Sepse unë sapa jam kthyer nga një aventurë.

Ata që më njohin nuk do të habiten nga ky pohim. Do të vënë buzën në gaz, do t'u shkojë mendja te nofka ime. Trapi, do të thonë, sidomos kur të mësojnë motivin që më shtyu të futesha qorrazi në një labirinth ngjarjesh ku nuk e dija ç'më priste. Por unë isha i sigurt se çfarëdo që të më ndodhte do të ishte më e mirë se vdekja ime e përditshme. Kjo më bën të heq dorë edhe nga dredhitë e kota, fjala vjen nga orvatja për të ngatërruar gjurmët me paralajmërimin klasik se gjithçka në këtë histori është trillim i fantazisë. Nuk ka pikë kuptimi një paralajmërim i tillë.

Zakonisht ai ka një qëllim të vetëm: të shërbejë si alibi për të fshehur të kundërtën. Unë marr përsipër të garantoj se i vetmi personazh që absolutisht nuk është trillim i fantazisë, ku nuk ka asnjë përputhje ose ngjashmëri të rastit e që fatkeqësisht më del në krye të rrëfimit, megjithë dëshirën time për ta shmangur, është Hadi.

2.

Sëmundjen e saj, kur, siç
thashë, m'u shfaq Hadi,
Marga ma bëri të ditur në rrethana aspak
dinjtoze për mua. Ishte fillimi i shtatorit '99,
vjeshta e fundit e mijëvjeçarit të dytë. Rruzulli
priste ndërrimin e epokave, gjashtë miliardë
banorët e Tokës – nuk e di shifrën e saktë –
pavarësisht profecive ogurzeza të Nostradamusit,
i përgatiteshin çastit të afërt magjik.

Tërë natën kisha parë ëndrra erotike. Prej disa
kohësh shihja ëndrra erotike. Çrregullimet e mia
duhet të kenë nisur pas një nate të nxehtë vere
kur Marga, tek bënim ose rrekeshim të bënim
seks, e mërzitur dhe pa e përballur dëshirën
time, më tha se i vinte keq, ajo nuk ndjente më
asgjë e unë përpiqesha më kot ta sillja në qejf.
Nuk e kapa menjëherë domethënien e pohimit
të saj, nuk desha ta pranoja. Ndërsa Marga
sikur mezi e kishte pritur atë çast, të shpëtonte
një herë e mirë nga unë. Më pas ajo nuk pranoi
kurrë të bënim seks, tani je i lirë, më thoshte,
bëj ç'të duash, s'kam kurrfarë xhelozie. Mirëpo,

kuptohet, tashmë isha i lirë vetëm për një gjë: të shihja ëndrra erotike. Në mjedisin tonë, ku nuk mbetet asgjë pa u marrë vesh, lapërdhitë vështirë t'i faleshin një cjapi si unë, në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare, me djalin e madh të martuar dhe një vajzë studente. Për më tepër, të vetëndjerit gjysh-im bir ma dha shumë shpejt këtë kënaqësi duke u martuar mjaft i ri e duke nxjerrë në dritë dy fëmijë njëri pas tjetrit-më zhyti në një humnerë impotence seksuale.

Kështu dhe atë natë kur, ndaj të gdhirë, Marga më njoftoi sëmundjen e saj: po shihja një nga ëndrrat erotike më intensive të atyre kohëve, duke bërë seks me një mike të afërt të vajzës sime. Turp, lajthitje të tilla njeriut nuk i lejohen as në ëndërr. Duhet pranuar, edhe ëndrra më e çmendur ka diçka të vërtetë. Siç është e vërtetë, për shembull, që Lori, mikësja e adhuruar e vajzës sime, nuk kalonte pa më tronditur sa herë vinte te ne, e unë bëja çmos të mos e shihja në sy, ndryshe do ta kisha të vështirë ta fshihja turbullimin tim të turpshëm. Fajtor, dyfish fajtor, para Margës dhe para Irmës, kështu quhet vajza ime.

Lori nuk më thërriste as xhaxha, as me ndonjë nofkë tjetër, por thjesht në emër. Në emër më thërriste edhe ime bijë çka, të them të drejtën, nuk më mërziste, ndërsa Marga nuk e gëlltiste dot këtë lloj snobizmi të tyre. Duke u nisur nga sytë blu dhe bardhësia e lëkurës, ngjyra natyrore e flokëve të Lorit duhej të ishte pak a

shumë e verdhë. Por kjo nuk mund të thuhej me siguri. Një ditë ajo u shfaq në kuadratin e derës gati e tëra në ngjyrë vishnje, që nga flokët, xhaketa prej lëkure, çizmet e gjata me taka të larta ngjitur pas këmbëve, deri tek aroma e trupit të saj, një aromë vishnjeje, siç m'u duk. Atë ditë në shtëpi nuk ndodhej as Marga, as Irma. Megjithatë Lori u fut brenda si në shtëpi të vet, më duhet të bëj një telefon, tha, dhe vajti në dhomën e pritjes ku mbanim telefonin, ngriti receptorin, formoi një numër. Unë kisha mbetur te dera e dhomës i hutuar. Ky hutim, kur ndoshta për herë të parë ndodhesha vetëm për vetëm me atë drejç vajze, më zbuloi bishën agresive të strukur brenda meje. Bisha nuk kishte ngordhur, siç kujtoja. Bisha qe gjallë. Sytë e saj shihnin format e trupit të Lorit, e përpinin. Tjetra fliste me zë të ulët, këpuste ndonjë batutë, të lutem mos flit gomarllëqe, i tha tërë seriozitet dikujt, këtu është dhe Kristi, babai i Irmës, po dëgjon gomarllëqet e tua e kushedi ç'thotë me vete.

Unë as dëgjoja as thoja gjë me vete. I shpërqendruar dola në korridor, nga korridori jashtë, te dera e apartamentit, si të doja të rrija sa më larg saj për të qetësuar bishën brenda meje. Pastaj edhe ajo doli në korridor. Me aromën vishnjë të kurmit. Me buzët vishnjë që puthën faqen time para se të largohej nëpër shkallë. Duke më lënë me ndiesinë trullosëse të gjinjëve të saj që ishin mbështetur lehtë mbi gjoksin tim.

Pa dyshimin më të largët se brenda meje kishte zgjuar një bishë. Pa e marrë me mend se që nga ajo ditë do të vinte rregullisht të më trazonte në ëndrrat e mia erotike.

Kështu, pra, edhe atë natë kur Marga më njoftoi për sëmundjen e saj. Po flija me Lorin në një akt të mundimshëm seksual, derisa realizova një orgazëm vishnjë. Atë çast hapa sytë dhe ndjeva një dënesë. Tej dritares po zbardhte. Qëndrova pa lëvizur, i shtrirë në brinjë: po dëneste Marga. Heshturazi. Si të trembej mos më zgjonte. Në fillim, ende nën pushtetin e ëndrrës, mendova se ndoshta, në përpjekjet virtuale për të depërtuar Lorin kisha rënkuar nëpër gjumë duke përmendur emrin e saj dhe Marga qante për shkak të çmendurisë sime. Pak minuta më vonë nuk e durova dot më dënesën, zgjata dorën, e preka. Ajo u drodh. U kthye nga unë dhe mëmëriti diçka që truri im mezi e zbërtheu. Jam sëmurë, tha, do të vdes.

Këto fjalë Marga i shqiptoi me sigurinë e zakonshme të rasteve të njohura për mua kur fliste tepër seriozisht. Megjithë banalitetin tim të atyre çasteve, nuk kisha ndonjë arsye të mendoja se ajo, ende pa hapur sytë, kërkonte të bënte një shaka të rëndë. Mirëpo pohimi i saj i papritur qe aq i pamëshirshëm, ndërsa unë në një gjendje aq të vajtueshme, sa qesha me zor. Nuk parashikohet në mënxyrat e Nostradamusit, i thashë dhe ia kalova dorën midis flokëve.

Nostradamusi nuk e ka parashikuar diçka të tillë... Ajo u ngrit ndenjtur. Kam nisur të dyshoj një vit më parë, foli. Tani nuk mban më, duhet të shkoj në spital.

Desha të këmbëngulja me shakanë hipokrite të Nostradamusit por kjo do të ishte një poshtërsi ndaj Margës. Atëherë, nën dritën e dobët të agut, pashë rrënimin e fytyrës së saj. Tani, kur i kujtoj ato çaste, mund të bëj një pohim të çiltër: Margën e kisha dashur tërë jetën, asnjë grua tjetër nuk e kishte zënë dot vendin e saj. Do të kishte qenë e arsyeshme t'ia thosha këtë. Nëmos atë mëngjes, në ditët e mëpastajme. T'i betohesha se ndryshe nga ç'mund të kujtonte ajo, ndryshe nga ç'mund të mendonin shumë të tjerë, nuk kisha dashur ndonjë grua siç kisha dashur atë. Por unë nuk i thashë gjë Margës as atë mëngjes, as në ditët e mëpastajme. Dhe nuk e kuptoj përse më kafshojnë brenga të tilla tani, kur ajo nuk është më. Të thuash se kërkoj të shfajësohem para kushedi se kujt. Të thuash se frika nga një gjyq i mundshëm më ka hyrë aq keq, sa me pohime të tilla kërkoj të fitoj një certifikatë mirësjelljeje.

Unë e kam ditur gjithmonë portretin që më bënë të tjerët: një aventurier me tru sa të peshkut. Njerëzve si unë, megjithatë, fati u jepkej vërbërisht ca dhurata të pamerituara. Në rastin tim, për shembull, një grua të mrekullueshme. E kjo grua e mrekullueshme, në rastin tim, paskej vajtur dëm si gjalpi në lëkurë të qenit. Kështu thoshin. Unë, pra, isha lëkura e qenit!

Hadi m'u shfaq atë ditë, kur gatiteshim të dilnim nga shtëpia me Margën për të vajtur në spital dhe unë po ndihesha si lëkurë qeni. Marga nuk deshi ta zgjonim Irmën. Nuk deshi t'i linim ndonjë shënim. Të shtunave, dhe atë ditë qe e shtunë, Irma nuk shkante në fakultet, s'kishte leksione. Të shtunave paradite ajo plotësonte pagjumësinë e një jave të tërë. Për t'u mbrojtur nga dielli Marga mori një çadër, unë vura një kasketë strehëgjërë me shenjën e Nju Jorkut. Kasketën ma kishte çuar nga Amerika im bir. Ai ndodhet prej pesë vjetësh në Shtetet e Bashkuara, në Nju Jork, emigrant ekonomik, si fitues i llotarisë amerikane. Punon në aeroportin J.F. Kenedi dhe e quajnë Tomi. Jo se ka lindur në ditën e Shën Thomait. Unë dhe Marga nuk e çanim kokën për shenjtorë. Ato kohë shenjtorët tanë ishin të tjerë. I Margës ishte italiani Xhani Morandi. Imi, anglezi Tom Xhons. Kur lindi Tomi, njëzet e tetë vjet të shkuara, e hodhëm në llotari dhe fitoi shenjtori im. Nuk kam qenë ndonjëherë tek ai në Amerikë, as ai nuk kishte ardhur të më shihte deri sa vdiq Marga. Fatmirësisht kjo kishte qenë tek ai dy vjet të shkuara gjatë verës.

Poshtë pallatit tonë, nga ana e përparme, matanë një rruge tërë gropa ku qysh herët në mëngjes lëvrijnë makina, hapet një shesh në formë katërkëndëshi. Nuk e di të ketë patur ndonjë emër ky shesh. Në dy anë ai rrethohet me pallate, në dy anë të tjera nga rrugë që

kryqëzohen. Para disa vitesh atje kishte vetëm një lulishte. Në mes të lulishtes, mbi një pedestal mermeri, ngrihej një shtatore, kopje në përmasa të zvogëluara e shtatores gjigante në qendër të kryeqytetit, përbri Muzeut Historik. Sipas disave, shtatorja e sheshit në fjalë nuk ishte po ajo e sheshit para muzeut. Sipas tyre këtu ishte vendosur krenarisht shtatorja e Stalinit. Sipas disa të tjerëve, ajo e Haxhi Qamilit. Ndërsa një pjesë jo e vogël njerëzish ngulin këmbë se aty ka qenë Marksi. Në këto kushte po e quaj thjesht shtatore, pa emër.

Një ditë, një turmë e egërsuar me krekosjen fodulle të shtatores, e hoqi prej andej. E rrëzoi, e tërhoqi zvarrë rrugëve të lagjes. Kjo ndodhi në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë, në të njëjtën minutë, kur një turmë tjetër e egërsuar, shumë më e madhe në përmasa, njëmijë fish nga ç'ishte më e madhe shtatorja e sheshit qendror krahasuar me shtatoren e sheshit tonë periferik, e tërhoqi atë zvarrë nëpër kryeqytet. Por kjo histori tashmë është harruar. Për disa kohë, sheshi ynë mbeti vetëm me lulishten dhe piedestalin bosh. Më pas, jo shumë larg piedestalit, dikush ngriti një kioskë, zuri të shiste hamburger, byrekë e pije freskuese. Si vuri mjaft para duke shitur gjëra të tilla – gojët e liga thoshin se ato shërbenin si mbulesë e një tregtie të dyshimtë, ku përziheshin dhe përfaqësues të rendit – ky ua mbathi në Kanada. Para se t'ua mbathte, kioskën ia paskej shitur dikujt tjetër e ky tjetri e zmadhoi,

e mbuloi me tendë, krijoi një rrethim me parmakë e zinxhirë, vuri karrike, brenda dhe jashtë, e ktheu në pijetore. Për të prishur syrin e keq, pijetores i vuri emrin “Piedestali bosh”. Në të vërtetë, ja sepse pak më tutje ishte një stacion autobusi, pra një pikë me lëvizje, ja sepse shumë shpejt u bë qendra më tërheqëse për të gjithë meshkujt e ngeshëm të lagjes, pijetorja rrinte vazhdisht plot.

Dritarja e dhomës sime, në katin e tretë, binte nga ana e sheshit. Prej andej gjithçka dukej si në pëllëmbë të dorës. Atë mëngjes të tmerrshëm, para se të ngrihej nga shtrati, Marga m’u lut të mos e shihja në trup. Për të qenë e sigurtë më urdhëroi të shkoja pranë dritares, t’i ktheja shpinën derisa të merrte në komo ndërresat që i duheshin e të futej në banjë. Iu binda, vajta pranë dritares.

Sapo kishte aguar dhe në atë orë ishte ende shpejt që meshkujt e ngeshëm të lagjes apo kalimtarë të rastit të mbushnin tryezat dhe karriget e pijetores “Piedestali bosh”. Kjo është arsyeja që mua më ra në sy diçka tepër e çuditshme. Nëse pijetorja qe bosh, pjesa tjetër e sheshit, prapa saj, qe plot. Një turmë burrash kishin zënë vend s’dihej qysh kur në ndenjëset prej betoni nën degët e pemëve-rrepe dhe eukalipte që, me të dalë dielli, krijonin një hije të dendur. Në përgjithësi ata ishin pensionistë me kapele republike ose me kasketa për t’u mbrojtur nga dielli. Rrinin grupe-grupe dhe nga lartësia e dhomës vura re se disa mbanin

nëpër duar letra bixhozi, disa gurë dominoje, disa qenë përkulur mbi fushat e shahut, të tjerë mbi fushat e tavllës dhe të gjithë, pa përjashtim, në xhepat e këmishave apo xhaketave, kishin gazeta. Mirëpo ata nuk lëviznin. Ata rrinin si të ngrirë, m'u duk sikur kishin tërë natën që rrinin atje si të ngrirë. U enda nëpër dhomë, ua vura veshin lëvizjeve të Margës në banjë, pastaj, pa i bërë ballë kureshtjes, vajta zura vend edhe një herë pranë dritares: turma e burrave vazhdonte të ndodhej atje, në pozicionin e ngrirë. Bashkë me ta zbulova Hadin.

Ai po rrinte në këmbë sipër shkallëve të mermerta, në një pozë prej shtatoreje, me njërën dorë të mbështetur te piedestali bosh, të thuash se sapo ishte rrëzuar prej andej dhe kërkonte të ngjitej prapë, me krahun të shtrirë në një drejtim të papërcaktuar të hapësirës. Koka e tij lëvizi ngathtësisht. I tronditur u largova nga dritarja. Marga doli nga banja dhe unë u shkëmbeva me të në korridor. Pa guxuar ta shihja në sy, u futa në banjë. Mbylla derën, shtrëngova tëmthat fort, çka më bëri mirë, ndryshe nuk do ta përballoja ngasjen për të vajtur në dritaren e banjës e të shihja edhe një herë nëse te sheshi i lokalit "Piedestali bosh", turma e burrave të ngurtësuar vazhdonte të gjendej nën degët e pemëve dhe ai, Hadi, shtatlartë e ceremonial, rrinte në atë pozën si të donte të ringjitej në piedestal, me dorën e zgjatur drejt një pike të papërcaktuar të hapësirës. Në të vërtetë, dora e tij tregonte një

drejtim shumë të qartë, nga lindja, ku gjendeshin Varrezat, por edhe këtë e kuptova më vonë. Aty për aty shtrëngimi gjer në dhimbje i tëmthave më bëri të mblidhja veten: duhej të kujdesesha për Margën. Duhej t'ia hiqja Margës nga koka idenë e vdekjes. Dhe shfaqja e Hadit në ato rrethana ishte e dëmshme. Tek rruhesha, mendja më vajti te miku im i vjetër, Doktorin N.T.

Po ta pranoj thënien sipas së cilës njerëzve të padenjë si unë Fati u bënte ca dhurata të pamerituara, doktorin N.T., autoritet mjekësor i njohur, ishte pas Margës dhurata ime tjetër e pamerituar. Kur gëzon miqësinë e një autoriteti të tillë, disa halle jo të vogla familjare, dua të them halle sëmundjesh, zgjidhen lehtë. Sigurisht, N.T. përfaqësonte për mua shumë më tepër. Në pikëpamje të shëndetit, megjithë abuzimet e mia, unë vetë trokisja rrallë në derën e dhomës së tij të vizitave, në Klinikën e Patologjisë së Përgjithshme, në katin e dhjetë të një godine në spitalin Nr.1 të kryeqytetit. Tek ai unë shkoja për arsye të tjera, kur zemra më lëshonte dhe ekzistenca e humbiste kuptimin. Po të mos përmend se me doktorin N.T. kam dhe një lidhje tjetër. Ai është martuar me Sofikën, dikur vajza më inteligjente në fisin e nënës sime të ndjerë, pra mund ta quaj me plot gojën dhëndër, një dhëndër i gjindshëm dhe i respektueshëm.

Me këtë rast, para se të vazhdoj më tej, e shoh të nevojshme t'i kërkoj mikut tim dhe dhëndrit